



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,  
mbajtur më 22.11.2024, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, ( i pavarur), kryesues i Kuvendit, Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Feim Osmani (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Dasmor Dürmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti, (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

**Munguan:** Petrit Reçica (LVV), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Berat Lahu (LVV), Ermal Osmani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi (PDK) dhe Arbnora Ajeti (PDK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Alban Zogaj, nënkryetar, Valbona Ajeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Donika Çetta, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Sibel Halimi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Kushtrim Mushica, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Lulëzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencës, Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Gëzim Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Transformimit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të qytetarëve dhe përfaqësues të medieve.

---

### Faqe nga 6

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi tha se për këtë mbledhje është paraprë ky

### Rend i ditës:

#### 1. Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Gëzim Sveçla** tha se, duke pasur parasysh situatën, ku të gjithë jemi dëshmitarë të ngjarjes që e pamë para hyrjes në sallën e Kuvendit, punëtorët e ndërmarrje publike komunale "Pastrimi" në shenjë pakënaqësie janë duke i shprehur brengat tyre. Andaj, në shenjë nderimi për ta dhe për ta dëgjuar zërin e tyre, i propozoj Kuvendit që një përfaqësuesi të tyre t'i jepet fjala për t'i paraqitur brengat që kanë.

**Alban Zogaj**, nënkryetar, theksoi se para se të hynim në seancë, ne e kishim një takim gjysmë orësh me përfaqësuesit e protestuesve, të cilët bashkë me nënkryetaren, Jehona Lushaku - Sadriu, i dëgjuam me vëmendje të plotë, i kemi para vetes edhe kërkesat e tyre të parashtruara në formë të shkruar, kërkesë serioze, kërkesë e cila vjen nga Sindikata, unë nga kjo foltore premtoj, që me seriozitet të lartë do t'i trajtojmë ato kërkesa në ditët në vijim dhe prapë do të kemi komunikim me Sindikatën, me menaxhmentin dhe me punëtorët e ndërmarrjes "Pastrimi".

**Gëzim Mehmeti** kërkoi nga anëtarët e Kuvendit të mos votohet propozimi për dhënien e fjalës së një përfaqësuesi të ndërmarrjes "Pastrimi", sepse çdo votim në mbledhje të jashtëzakonshme nënkupton që ne kemi bërë shkelje ligjore sa i përket rrethanave në Kuvend. Kërkoj që njërit prej përfaqësuesve të ndërmarrjes t'i jepet fjala, t'i dëgjojmë brengat e tyre dhe më pas ta organizojmë një mbledhje të jashtëzakonshme, ku të gjithë i paraqesin kërkesat dhe shqetësimet e tyre.

**Fatos Dibra** kujtoi për të pranishmit se në kushte normale, me rregullore publiku fjalën mund ta marrë vetëm në mbledhje të komiteteve dhe jo në mbledhje të Kuvendit komunal, e atëherë më pak në mbledhje të jashtëzakonshme të buxhetit.

Para se të marrë fjalën përfaqësuesi i ndërmarrjes, kryesuesi tha se të gjithë përfaqësuesit e partive politike u pajtuan që t'i jepet fjala përfaqësuesit të ndërmarrjes "Pastrimi".

**Kryesuesi** e ftoi përfaqësuesin e ndërmarrjes, z. Ardian Krasniqi, që t'i paraqesë problemet dhe brengat e tyre para anëtarëve të Kuvendit.

**Ardian Krasniqi**, kryetari i Shoqatës sindikale "Pastrimi", kërkoi që nga Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave të hiqet neni 16, pika 3, ku thuhet se "Komuna e Prishtinës

*mund të angazhojë kompani tjetër për t'i ndihmuar kompanisë regjionale të mbeturinave "Pastrimi", në rast të vështirësive gjatë operimit" dhe që kjo nënkupton edhe heqjen e tenderit të cilin e ka shpallur Komuna, sepse rrezikohet e ardhmja e 900 punëtorëve të ndërmarrjes dhe operatori i vetëm për grumbullimin e mbeturinave të jetë KRM "Pastrimi". Pra, kërkojmë largimin e operatorit privat.*

**Gëzim Sveçla** tha se sa i përket Propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2025, si mund të diskutohet dhe më pas të votohet kjo pikë kur në këtë mbledhje mungon Kryetari i Komunës, andaj kërkojmë të dijmë se çfarë është arsyeja që na keni thirrur për këtë seancë nëse nuk është Kryetari, si autoriteti më i lartë në Komunë.

**Jeta Rafuna** tha se sot është hera e tretë që po diskutojmë për projektbuxhetin për vitin 2025, e që kryetari në seancën e kaluar vetë e ka prezantuar këtë projektbuxhet. Ne si Grup parlamentar, mendojmë se mund të vazhdojmë me diskutimin dhe miratimin e tij, pasi që arsyeshmërinë për miratimin e tij mund ta japin nënkryetari dhe drejtorja e Drejtorisë së Financave.

Vota për këtë buxhet është votë për shëndetësi më të mirë, për arsim më cilësor, për mirëqenie sociale, për zhvillim ekonomik, për sport dhe kulturë, pra në tërësinë e saj për një jetë më të mirë dhe më të dinjitetshme të qytetarëve tanë.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se të diskutohet për miratimin e buxhetit për vitin 2025 dhe të mos jetë i pranishëm Kryetari i Komunës, mendoj se është e pakuptimtë, kështu që ne duam të dijmë se pse Kryetari i Komunës vazhdon të ikën nga qytetarët, pse Kryetari i Komunës vazhdon të ikën nga asamblistët, pse Kryetari i Komunës nuk ka publikuar asnjë projekt në këtë projektbuxhet që e kemi pasur si kërkesë, pse Kryetari i Komunës nuk ka zhvilluar dëgjim publik me qytetarë për projektbuxhetin. Të sille projektbuxheti në seancë të jashtëzakonshme e mos të jetë i pranishëm Kryetari është hajgare, po ikën nga përfaqësuesit e qytetarëve, po ikën nga protestuesit, po ikën nga dëgjimi publik, po merr vendime të paligjshme, del zhvillon aktivitete kur ka masë të sigurisë së gjykatave etj. Kryetari nuk është duke e trajtuar buxhetin e qytetarëve ashtu siç i takon një përfaqësuesi që u votua me votë të qytetarëve të kryeqytetit. Projektbuxheti është përafërsisht i njëjtë, asnjë hap nuk është bërë për t'i informuar qytetarët, të paktën siç e parasheh ligji, me bërë një diskutim publik me qytetarë për projektbuxhetin.

**Bahri Gashi** u shpreh se ky buxhet nuk është i AAK-së, as i LDK-së, ky buxhet është për qytetarët e Prishtinës dhe e përkrahim miratimin e tij.

**Sami Boroci** theksoi se sa i përket mos pranisë së Kryetarit, që u diskutua nga parafolësit, mund të konstatoj se, Kryetar që ka marrë pjesë në seanca të Kuvendit më të rregullt se Përparim Rama nuk ka pasur. Këtë e them me përgjegjësi të plotë. Besoj se sot duhet dhënë një epilog dhe të votohet projektbuxheti, sepse ky nuk është buxhet i Përparimit, as i Albanit, as i Jehonës, ky është buxhet që ka me prekur dhe ka me përmirësuar jetën e qytetarëve të Prishtinës. Unë do ta votoj këtë buxhet, për shkak se është buxhet që e prek sportin, e prek shëndetësinë, i prek shërbimet publike, infrastrukturën e të gjitha.

**Feim Osmani** tha se, përderisa kjo mbledhje e jashtëzakonshme është propozuar nga vetë Kryetari, del se ai nuk është i pranishëm sot këtu, më krijon bindjen se nuk është buxhet i përgatitur siç duhet. për arsye se mungesa e Kryetarit e shpërfaq mungesën tij dhe të dëgjimeve publike, edhe nëse nuk ka marrë pjesë në dëgjime publike, nuk i ka ditur saktësisht kërkesat e banorëve. Të diskutohet sot për buxhetin e vitit 2025 është krejtësisht e panevojshme, sepse nuk kemi kujt t'i drejtohem dhe nga kush të kërkojmë llogari për këtë projektbuxhet që ka ardhur për miratim. Kisha kërkuar që sot të tërhiqet kjo pikë, sepse nuk po më duket që ka interesim faktik as të Kryetarit, as të ekzekutivit, e as të LDK-së për ta votuar buxhetin, sepse është thirrur një seancë e jashtëzakonshme pa i siguruar numrat dhe pa bërë asnjë ndryshim të vetëm në projektbuxhet.

**Gëzim Mehmeti** tha se kjo vonesë e miratimit të buxhetit për vitin 2025, përfaqëson jo vetëm një dështim administrativ, por një pasojë direkte për zhvillimin dhe mirëqenien e qytetit tonë të Prishtinës. Kjo situatë nuk ndikon vetëm në projekte afatgjate, por edhe në shërbimet bazike të përditshme për qytetarët e Prishtinës.

Mos miratimi i buxhetit për vitin 2025 nuk është vetëm një problem teknik apo procedural, është një akt që do të ketë pasoja të rënda në çdo aspekt të jetës së qytetarëve të Prishtinës. Hartimi i këtij buxheti nuk ka përfshirje të mjaftueshme të opozitës, Shoqërisë civile, duke e bërë atë të duket më shumë si një dokument i njëanshëm sesa një pasqyrë e konsensusit qytetar. Pavarësisht shqetësimeve rezervave që i kam, dua të theksoj se mos miratimi i buxhetit nuk është zgjidhje. Mos miratimi i buxhetit do të kishte pasoja edhe më të rënda, si paralizimi total i projekteve, dështimi i ofrimit të shërbimeve bazike. Pavarësisht bindjeve politike, ne duhet të tregojmë pjekuri dhe përgjegjësi. Çdo bllokim që e bëjmë, çdoherë pasojat do t'i ketë qyteti dhe qytetarët e saj. Nuk e votojmë buxhetin për nder të Kryetarit, e votojmë sepse bllokohet qyteti.

**Endrit Zabërgja** tha se ne duke mos marrë pjesë në votim të buxhetit, po bllokojmë shumë projekte, po rrezikojmë bllokimin e kontratave, rrezikojmë vizionin të cilin e ka Kryetari për transformim e Prishtinës. Si shefa të grupeve parlamentare, kemi qenë të ftuar në një takim nga Kryetari, ku Kryetari na ka ftua që secili nga ne të propozojmë projektet tona, për të qenë ky buxhet gjithëpërfshirës. Nga ai takim unë kam parë hezitime dhe nuk besoj që ka pasur takime ose ndonjëri prej kolegëve ka dërgu ndonjë projekt, nëse po, atëherë do diskutojmë për tema, jo për përmbajtje dhe tendenca për ta bllokuar punën e Kryeqytetit. Besoj se është mjaft shqetësuese, sepse pastaj kjo po kalon në një kulturë, e këtë kulturë nuk e meritojnë qytetarët e Prishtinës. Andaj, edhe njëherë kisha kërkuar nga gjitha partitë politike që jemi prezentë, që t'i tejkalojmë kalkulimet ditore, politike dhe të merremi vesh, të ulemi e të arrijmë deri te kompromisi i nevojshëm për kalimin e kësaj pike.

**Granit Geci** theksoi se nuk mundemi të shtyjmë përpara tema të interesit vital, nëse të

paktën nuk jemi të sinqertë me njeri-tjetrin. Sikur të ishte aq shumë i rëndësishëm ky buxhet Përparimin do ta kishim këtu, kështu që arroganca e tij para disa qëndrimeve legjitime që i kemi ne si parti, të cilat po i përfaqësojmë ata qytetarë, nuk po na merren parasysh nga kryetari.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se kjo që po ndodh sot është diçka që se kemi parë asnjëherë me parë. Jemi në fund të muajit nëntor dhe ende nuk është votuar buxheti për vitin e ardhshëm. Ne me shumë vëmendje e dëgjuam nënkryetarin dhe mundë të them që fjalët e tij tingëllojnë shumë bukur, mirëpo realiteti praktik është krejt tjetër. Kërkoj të dijë arsyen e mos pranisë së Kryetarit në këtë seancë, cila është urgjenca e seancës së thirrur për sot dhe pse nuk është thirrur para se të udhëtojë kryetari për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose pasi të kthehet nga udhëtimi? Kjo nuk ka si quhet ndryshe, përveçse tallje me Kuvendin komunal, tallje me qytetarët e Prishtinës!

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Valbona Makolli, drejtore, dhe Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës.

**Bahri Gashi** u shpreh se nëse nuk votohet ky buxhet, do të dëmtohen qytetarët e Prishtinës, megjithatë për nënkryetarin dhe për drejtoreshën e Financave, besoj se patën kolegët disa kritere dhe kërkesa, disa thirrje, nëse kjo seancë nuk e kryen punën, është mirë me i marrë parasysh ato dhe me pa çka mundet me u plotësua në këtë buxhet. Kjo vonesë e buxhetit do të na kushtojë shumë, sespe do të vazhdojë me çaluar edhe vitin e ardhshëm, kështu që ne si Aleancë do ta votojmë buxhetin dhe besoj se do të kalojë.

**Nora Kelmendi** theksoi se në mbledhjen e parë, kur kemi pasur propozime për buxhet, në shtator, ne si Grup i asamblistëve kemi shtuar disa pyetje të caktuara dhe Kryetari na ka premtuar që përgjigjet do t'i marrim këtu në seancë, apo përmes postës ekektionike.

Përgjigjet nuk i kemi marrë as nga posta elektronike, as në seancë, përveç një drejtoreshës që na i ka dërguar përgjigjet. Po ashtu, edhe në mbledhjen e dytë i kemi parashtyruar po ato kërkesa dhe prapë nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Andaj, kërkojmë të dijmë se a janë marrë parasysh kërkesat e qytetarëve që ato të përfshihen në këtë buxhet, pra publikisht të tregoni në këtë buxhet cilat kërkesa të qytetarëve për projekte kapitale i kemi në buxhtin e vitit 2025.

**Arianit Beqiri** u shpreh se ne çdoherë jemi kritikuar nga LDK-ja, por ka shumë raste që edhe e kemi përkrah ekzekutivin kur edhe vetë partia e tyre nuk i ka përkrahur dhe me votën tonë i kanë kaluar pikat e rendit të ditës, prapë se prapë nënkryetari dhe pjesa tjetër e ekzekutivit nuk është se kanë dashur me u bashkuar rreth Prishtinës. Një numër vendimesh që janë marrë edhe prej ministrive të linjës, të cilat edhe i monitorojnë punët e Kuvendit komunal dhe vendimet që derivojnë prej tyre dhe pavarësisht refuzimit të tyre sipas dispozitave ligjore, prapëseprapë keni vazhdu me publikimin e tyre dhe miratimin e tyre, kështu që nuk ka ekzistuar në asnjë moment një grimcë gatishmërie nga ana juaj për bashkëpunim.

Faqe5nga6

Gëzim Sveçla u shpreh se po shihet qartë që ekzekutivi nuk ka kompetenca për me vendosur asgjë për buxhet, nuk kanë as përgjigje në pyetjet e asamblistëve, andaj në një situatë të tillë është e palogjikshme të kërkohet prej nesh që qëndrojmë dhe të votojmë, nuk ka kurrfarë sensi logjik as politik, as njerëzor, andaj derisa të ketë një reflektim nga ana e ekzekutivit situata mbetet e tillë, ne nuk e votojmë këtë projektbuxhet.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar rreth diskutimit të projektbuxhetit, në shenjë pakënaqësie GP i PDK-së dhe GP i LVV-së e lëshuan mbledhjen.

*Në mungesë të kuorumit, kryesuesi konstatoi mbledhjen të mbyllur.*

*Mbledhja përfundoi në orën 13:00.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Fehmi Kupina**

